



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-113

Prishtinë, më 10 qershor 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 10 QERSHOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Petar Miletqi dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavljeviq, Myfera Shinik dhe Goran Marinkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Skender Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 qershor 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 qershor 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 qershor 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

a) Vazhdimi i seancës plenare

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me vazhdimin e mbledhjes plenare, të filluar më 6 qershor 2013, vendosi që ajo t'i vazhdojë punimet të enjten, më 13 qershor 2013, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Votimi i raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2012,*
2. *Votimi i raportit vjetor të punës së Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës për vitin 2012,*
3. *Votimi i Raportit vjetor së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2012,*
4. *Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me Strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës, 2009-2015,*
5. *Debat parlamentar lidhur me rirregullimin (heqjen) e taksave të sigurimeve të automjeteve të udhëtarëve dhe automjeteve transportuese të mallrave.*

b) Seanca plenare e radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për mbajtjen e seancës së rregullt, vendosi që ajo të mbahet të enjten, më 13 qershor 2013, me fillim në orën 12:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë e mallrave strategjike,*
- 5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet e ndërtimit,*
- 6. Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media.*

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale